



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 369 / 7 Prot.

Tiranë, më 25 . 09. 2019

V E N D I M

Nr. 82 , Datë 25.09.2019

MBI
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË
NË TË USHTRUAR NË BASHKINË LIBOHOVË
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2019, ndërsa për prokurimet
publike nga data 01.01.2016 deri më datën 30.06.2019)

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Libohovë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të pa modifikuar (i pa kualifikuar) me theksim të çështjes mbi pasqyrat financiare. Në fushën e prokurimeve publike janë konstatuar devijime nga kuadri rregullator në fuqi të cilat konsiderohen materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesit, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm (Drejtori i Auditit të Brendshëm shqyrtoi në emër të tij), në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Libohovë”, sipas programit të auditimit nr. 369/1 prot., datë 28.05.2019 dhe shkresës nr.369/2 prot., datë 04.07.2019 “Njoftim për ndryshim në programin e auditimit”, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.06.2019, ndërsa për prokurimet publike nga data 01.01.2016 deri më datën 30.06.2019.

II. Të miratoj opinionin, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionit i pa modifikuar (i pa kualifikuar), me theksim të çështjes mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Libohovë për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, etj., shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për të siguruar bazën për opinionin mbi pasqyrat financiare. Edhe pse janë audituar dhe janë evidentuar mangësitë për pasqyrat e dy viteve ushtrimore, opinionit ynë fokusohet në pasqyrat financiare të vitit 2018, për arsye se në këtë vit është e pasqyruar edhe situata e vitit 2017. Në opinionin tonë, përse i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Libohovë, të standardeve dhe ligjit të kontabilitetit mbi pasqyrat financiare, në përgjithësi ato japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar, të performancës financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare më datën 31.12.2018. Kjo referuar Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre, si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”, UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Pasqyrat financiare edhe pse konsiderohen të pranueshme, për arsye të informimit të përdoruesve të tyre dhe subjektit të audituar, duhet të theksojmë disa mangësi (jo materiale), të cilat duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre. Këto mangësi efektet e të cilave nuk ndryshojnë opinionin tonë të mësipërm, paraqiten në paragrafin e mëposhtëm të theksimit të çështjes:

Baza për dhënien e opinionit

Nga auditimi u konstatua së kontabiliteti i njësisë publike nuk është mbajtur sipas kuadrit rregullator në fuqi, sepse nga sektori i financës për vitin 2017 dhe 2018 nuk është mbajtur ditar i blerjeve, por vetëm ditar dhe libër magazine, duke mos rregjistruar dhe kontabilizuar në mënyrë kronologjike të gjithë veprimtarinë e blerjeve të institucionit për punët dhe shërbimet, por vetëm për mallrat të cilat janë bërë hyrje. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i madh për rregjistrimet përmbledhëse mujore në kontabilitet (tepricat mujore debitorë dhe kreditore sipas llogarive). Mos kryerja e këtyre veprimeve ka sjellë edhe anomalitë e konstatuara në pasqyrat financiare.

- Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “*Studime e projekte*”, në vitin 2018 nuk paraqet vlerën reale të saj për arsye se në këtë llogari përfshihet edhe vlera 5,645,745 lekë, e mbartur nga pasqyrat financiare të ish Komunës Zagorie, për të cilën nuk ka dokumentacion se çfarë objekti përfaqëson. Gjithashtu në 31.12.2018 kjo llogari në mënyrë të gabuar përfshinë edhe vlerën e tetë projekteve prej 573,000 lekë, të cilat duhet të paraqiteshin në vlerën e investimeve tashmë të përfunduara.

- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” dhe llogaria 211 “*Pyje, Kullota Plantacione*” për vitin 2017 dhe 2018, sipas të dhënave të aktivitetit të pasqyrave financiare, kanë vlerën zero lekë, duke mos u paraqitur vlera e vërtetë e pasurisë së institucionit për këto pasuri, pasi njësisia vendore administron një numër të konsiderueshëm asetesh për llogaritë e mësipërme, por të pa rregjistruara ende në ZRPP.

- Në harimin e pasqyrave financiare në disa raste nuk është zbatuar parimi kontabël i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (Kontabiliteti Rritës), sipas të cilit efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhën). Konkretisht si më poshtë:

a- Llogaria 212 “*Ndërtime e konstruksione*” për vitin 2018 nuk pasqyron vlerën e saktë të aktiveve të kësaj llogarie. Në këtë vit ka filluar dhe ka përfunduar marrja në dorëzim e objektit

“Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”, me vlerë totale 54,344,090 lekë pa TVSH, por në pasqyrat e vitit 2018 është pasqyruar vetëm vlera e likuiduar e investimit, prej 23,503,114 lekë, duke ngelur jashtë kësaj llogarie vlera 30,840,997 lekë.

b- Për llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për vitin 2017 dhe 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë rregjistruar në periudhën ushtrimore kur ka ndodhur ngjarja. Këto vlera lidhen me investime të përfunduara brenda vitit ushtrimor, por të pa pasqyruara dhe konkretisht:

- “Rikonstruksion i qendrës së fshatit Sheper”, me vlerë të kontratës 1,542,700 lekë pa TVSH, ka përfunduar në vitin 2017. Vlera e këtij investimi në mënyrë të gabuar nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 por në vitin 2018.

- Investimi me objekt “Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës kthesa e Labovës - Labove e Kryqit”, me vlerë 118,213,623 lekë pa TVSH (objekti ka filluar në vitin 2016 dhe është marrë në dorëzim në datën 06.12.2017). Në mënyrë të gabuar vlera 19,959,000 lekë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe jo të vitit 2017. E gjithë vlera e investimit duhet të ishte pasqyruar në vitin 2017.

c- Në vitin 2017 është zhvilluar tenderi me objekt “Rikonstruksion i rrugës Kthesa - Ura e Suhes (loti I), me datë fillimi të punimeve 22.08.2017 dhe datë përfundimi dhe marrjes në dorëzim të punimeve 24.11.2017, vlerë të kontratës 48,484,848 lekë pa TVSH. E gjithë vlera e investimit duhet të ishte pasqyruar llogarinë 213 në pasqyrat financiare të vitit 2017, por në fakt në këtë vit është pasqyruar vetëm vlera 25,458,720 lekë, ndërsa diferenca prej 23,026,128 në mënyrë të gabuar është pasqyruar në pasqyrat e vitit 2018.

- Në vitin 2017 për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” janë pasqyruar aktive të nxjerra jashtë përdorimit në vitin 2016, në vlerën 506,710 lekë, duke mos u pasqyruar ngjarja ekonomike në periudhën ushtrimore kur ajo ka ndodhur.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 Llogaria aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), si kundërparti e llogarive pasive, nuk jep informacion të saktë, pasi nuk përfshin të gjithë vlerën e të drejtave që njësi vendore ka ndaj shtetit.

Për vitin 2017, vlera totale e detyrimit që njësi vendore ka ndaj të tretëve në datën 31.12.2017 është në vlerën 105,915,183 lekë, por për këtë vit llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), ka një vlerë prej 14,946,355 lekë, pra nuk përfshin vlerën 90,968,828 lekë, e cila në pasiv përfaqëson llogarinë 467 –Kreditorë të ndryshëm.

Edhe në vitin 2018 konstatohet se llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), ka një vlerë prej 15,193,611 lekë dhe nuk pasqyron të gjithë vlerën e të drejtave të njësisë vendore. Gjithashtu kjo llogari nuk pasqyron të gjithë vlerën e detyrimeve që njësi vendore ka ndaj të tretëve, vlerë e cila është pasqyruar në llogaritë përkatëse të pasivit dhe që kanë një shumë prej 20,880,456 lekë. Vlera e llogarisë pasive 467 “Kreditorë të ndryshëm”, prej 5,686,845 lekë, për vitin 2018 nuk është përfshirë te llogaria aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor).

Opinion i modifikuar (i kualifikuar) për prokurimet publike

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përse i takon shkallës së zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi (kriteret e vlerësimit) për fushën e prokurimeve publike nga subjekti Bashkia Libohovë, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave dhe zbatimit të kontratave. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Në katër raste janë konstatuar shkelje të procedurave të prokurimit publik, të cilat kanë sjellë kualifikim të operatorit fitues i cili nuk plotëson kriteret dhe specifikimet e vendosura në DST,

me pasojë përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën totale 128,995,868 lekë pa TVSH.

- Në tre raste janë s'kualifikuar operatorë ekonomikë për devijime të vogla, duke sjellë efekte financiare negative në buxhet në vlerën totale 14,406,578 lekë pa TVSH.

Në shtatë raste janë konstatuar pagesa për volume punimesh të situacionuara, por të pa kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 4,615,166 lekë pa TVSH.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore Bashkia Libohovë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. I njëjti arsyetim vlen edhe për çështjet e prokurimeve publike.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogaria 211 "Pyje, Kullota Plantacione" për vitin 2017 dhe 2018 kanë vlerën zero lekë në aktivin e pasqyrave financiare, duke mos u paraqitur vlera e vërtetë e pasurisë së institucionit. Në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", dhe në llogarinë 211 "Pyje, Kullota Plantacione", nuk janë përfshirë asetet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, të cilat janë transferuar në pronësi të saj me VKM nr. 415, datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës", VKM nr. 706, datë 12.10.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Zagorie, të Qarkut të Gjirokastrës", si dhe VKM nr. 272, datë 21.04.2010 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Libohovë, të Qarkut të Gjirokastrës", VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish komunave/bashkive". Këto asete nuk janë regjistruar në pronësi të Bashkisë Libohovë dhe në këto kushte llogaria 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogaria 211 "Pyje, Kullota Plantacione", nuk paraqet vlerën reale të pasurisë së institucionit. Për pasuritë e dy llogarive të mësipërme nuk ka plan menaxhimi nga njësia vendore me qëllim rregjistrimin e tyre në ZRPP (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa për hartimin e një plani menaxhimi për pasuritë e mësipërme me qëllim evidentimin e statusit të tyre juridik, rregjistrimin në ZRPP dhe pasqyrimin në kontabilitet të numrit dhe vlerës së këtyre aseteve.

Deri në fund të vitit 2019

2. Gjetje nga auditimi: Llogaria 212 “Ndërtim e konstruksione” për vitin 2018 nuk pasqyron vlerën e saktë të aktiveve të kësaj llogarie. Në këtë vit ka filluar dhe ka përfunduar marrja në dorëzim e objektit “Rikonstruksion dhe ndërtim palestere i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”, me vlerë totale 54,344,090 lekë pa TVSH, por në pasqyrat e vitit 2018 është pasqyruar vetëm vlera e likuiduar e investimit, prej 23,503,114 lekë, duke ngelur jashtë kësaj llogarie vlera 30,840,997 lekë. Nuk është zbatuar parimi kontabël i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas të cilit si të ardhurat dhe shpenzimet kontabilizohen në momentin kur ngjarja ekonomike ndodh dhe jo në momentin kur arkëtohen/paguhen flukset monetare të lidhura me transaksionin. Gjithashtu për këtë llogari nuk ka informacion se çfarë objekti përfaqëson vlera 4,687,737 lekë, e trashëguar nga ish komunat.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë të marrë masa për të identifikuar se cilat aktive përfaqëson vlera 4,687,737 lekë, e cila në analizën e llogarisë 212 ka përshkrimin “vlerë tjetër”. Për arsye se kjo vlerë është e mbartur nga pasqyrat financiare të ish komunave, të shfrytëzohet dokumentacioni i tyre përkatës, duke përcaktuar origjinën e krijimit të saj. Në vijimësi për pasqyrimin e të dhënave në kontabilitet të zbatohet parimi kontabël i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

3. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 213, “Rrugë rrjete vepra ujore” për vitin 2017 dhe 2018, transaksionet dhe ngjarjet nuk janë rregjistruar në vitin e duhur ushtrimor. Këto vlera lidhen me investime të përfunduara brenda vitit ushtrimor, por të pa pasqyruara në vlera të plota në pasqyrat financiare, konkretisht:

- Investimi me objekti “*Rikonstruksion i qendrës së fshatit Sheper*”, me vlerë të kontratës 1,542,700 lekë pa TVSH, ka përfunduar dhe është marrë në dorëzim në vitin 2017. Vlera e këtij investimi në mënyrë të gabuar nuk është pasqyruar në aktivin e pasqyrave financiare të vitit 2017 në llogarinë 213, por në vitin 2018.

- Investimi me objekt “*Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës kthesa e Labovës - Labove e Kryqit*”, me vlerë 118,213,623 lekë pa TVSH (objekti ka filluar në vitin 2016 dhe është marrë në dorëzim në datën 06.12.2017), por në mënyrë të gabuar vlera 19,959,000 lekë është pasqyruar në aktivin e pasqyrave financiare të vitit 2016 në llogarinë 213. E gjithë vlera e investimit prej 118,213,623 lekë duhet të ishte pasqyruar në aktivin e pasqyrave financiare të vitit 2017 në llogarinë 213. Deri në momentin e përfundimit të investimit, shpenzimet e kryera duhet të ishin mbajtur në llogarinë 23.

- Në vitin 2017 është zhvilluar tenderi me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Kthesa - Ura e Suhes (loti I)*”, me datë fillimi të punimeve 22.08.2017 dhe datë përfundimi dhe marrjes në dorëzim të punimeve të punimeve 24.11.2017 vlerë të kontratës 48,484,848 lekë pa TVSH. Pra e gjithë vlera e investimit duhet të ishte pasqyruar llogarinë 213 në pasqyrat financiare të vitit 2017, por në fakt në këtë vit është pasqyruar vetëm vlera 25,458,720 lekë, ndërsa diferenca prej 23,026,128 në mënyrë të gabuar është pasqyruar në pasqyrat e vitit 2018. Për sa më sipër në mënyrë të gabuar regjistrimet kanë ndjekur parimin e pagesës dhe jo parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim Sektori i financës në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojnë sipas parimit kontabël të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “*Studime e projekte*”, në pasqyrat financiare të vitit 2017 paraqitet në vlerën 6,957,145 lekë, ndërsa për vitin 2018 kjo llogari ka vlerën neto 6,909,645 lekë (zbritur amortizimi i akumuluar në vlerën 47,500 lek). Shtesat në vitin 2017 përbëhen nga vlera e dy projekteve: Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë; Rikonstruksion i rrugës Kthesa - Ura e Suhës (loti 1). Nuk ka shtesa projektesh në kontabilitet për vitin 2018.

Në këtë llogari në mënyrë të gabuar përfshihet edhe vlera e tetë projekteve prej 573,000 lekë, që i përkasin periudhës 2016-2018, për tetë investimeve të përfunduara, vlera e të cilave nuk duhet të ishte pjesë e kësaj llogarie, por duhet të shtohet në vlerën e investimeve përkatëse pas përfundimit dhe marrjes së tyre në dorëzim.

Gjithashtu konstatohet se në llogaria 202 paraqitet edhe vlera 5,645,745 lekë për të cilën sektori i financë nuk ka informacion se çfarë projektesh përfaqëson, me argumentin se kjo vlerë është e mbartur nga pasqyrat financiare të ish Komunës Zagorie pa shpjegime konkrete.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Sektori i financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 6,218,745 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara. Për këtë qëllim njësia vendore ti referohet projekteve në vlerën 573,000 lekë të realizuara gjatë periudhës 2016-2018, si dhe investimeve të këtyre projekteve të cilat kanë përfunduar në këtë periudhë, por nuk mbartin në vlerën e tyre vlerën e projekteve. Për vlerën e trashëguar nga ish komunat, në dokumentacionin financiar përkatës në arshivë, të verifikohet viti i krijimit të vlerës së mësipërme dhe investimi përkatës, në të cilin të shtohet vlera e mësipërme.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

5. Gjetje nga auditimi Në pasqyrat financiare të vitit 2017, llogari 218 “*Inventar ekonomik*” ka vlerën 20,470,218 lekë dhe krahasuar me vitin 2016 kjo llogari është shtuar me vlerën 6,876,050 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i blerjeve në vlerën 7,382,760 lekë dhe nga nxjerrja jashtë përdorimit në vlerën 506,710 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit të vitit 2017, nuk konstatohen aktive të nxjerrja jashtë përdorimit, por vlera e mësipërme është rezultat i procedurave të ndjekura në vitin 2016, por të pa pasqyruara në pasqyrat e këtij viti. Pra në vitin 2017 për llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*” janë pasqyruar aktive të nxjerrja jashtë përdorimit në vitin 2016, në vlerën 506,710 lekë, duke mos u pasqyruar ngjarja ekonomike në vitin ushtrimor përkatës (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim Sektori i financës të marrë masa që gjatë kryerjes së inventarizimit vjetor të aktiveve të njësisë vendore, në përfundim të procesit të inventarizimit, të pasqyrojë në pasqyrat financiare të atij viti ushtrimor, rezultatet e inventarizimit dhe jo në vitin e ardhshëm.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 Llogaria aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), si kundërparti e llogarive të pasivit, nuk jep informacion të saktë, pasi nuk përfshin të gjithë vlerën e të drejtave që njësia vendore ka ndaj shtetit. Për vitin 2017, vlera totale e detyrimit që njësia vendore ka ndaj të tretëve (përfshijë pagat, sigurimet) për faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2017 është në **vlerën 102,417,301 lekë** dhe përbëhet nga llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, e cila ka vlerën 11,448,473 lekë dhe llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, e cila ka vlerën 90,968,828 lekë. Vlera 102,417,301 lekë në, korrespondon me vlerën e detyrimeve të prapambetura të raportuar në Ministrinë e Financave për vitin 2017. Detyrimet për pagat dhe sigurimet janë në vlerën 3,497,882 lekë, duke bërë që detyrimi total të jetë **105,915,183 lekë**.

Nga auditimi konstatohet se në pasqyrat financiare të vitit 2017 llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), ka një vlerë prej 14,946,355 lekë dhe nuk pasqyron të gjithë vlerën e të drejtave të njësisë vendore ndaj shtetit (si dhe vlerën e detyrimeve që njësia vendore ka ndaj të tretëve), vlerë e cila është pasqyruar në llogaritë përkatëse të pasivit dhe që kanë një shumë prej

105,915,183 lekë. Pra llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), duhet të kishte vlerën 105,915,183 lekë, por në fakt ka vlerën 14,946,355 lekë. Vlera e llogarisë pasive 467 – Kreditorë të ndryshëm në vlerën 90,968,828 lekë, për vitin 2017, nuk është përfshirë te llogaria aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor).

Edhe në vitin 2018 konstatohet se në aktivin e pasqyrave financiare llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), ka një vlerë prej 15,193,611 lekë dhe nuk pasqyron të gjithë vlerën e të drejtave të njësisë vendore ndaj shtetit. Gjithashtu kjo llogari nuk pasqyron të gjithë vlerën e detyrimeve që njësia vendore ka ndaj të tretëve, vlerë e cila është pasqyruar në llogaritë përkatëse të pasivit dhe që kanë një shumë prej 20,880,456 lekë. Pra llogaria 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), duhet të kishte vlerën 20,880,456 lekë, por në fakt ka vlerën 15,193,611 lekë. Vlera e llogarisë pasive 467 –Kreditorë të ndryshëm prej 5,686,845 lekë, për vitin 2018 nuk është përfshirë te llogaria aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor) (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandim Sektori i financës në mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2019, të pasqyrojë në llogarinë 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor), si të drejta të saj ndaj shtetit, të gjitha detyrimet që njësia ka dhe për të cilat burimi i financimit janë fondet buxhetore. Vlera e detyrimeve ndaj të tretëve në pasiv, me burim fondesh buxhetin e shtetit, duhet të rakordojë me vlerën e llogarisë aktive 4342-Te tjera operacione me shtetin (debitor).

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

7. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2017 janë realizuar gjithsej 15 investime, për të cilat janë hartuar projektet përkatëse, katër prej të cilave (projekteve) janë dhuruar nga projektuesit privatë, përkatësisht për objektet “Skema ujitëse e Suhës (fusha e Suhës) vazhdim/mbarim”, “Rikonstruksioni i rrugës kthesa – ura e Suhës (loti 1)”, “Rikonstruksion i rrugës kthesa e Nepravishtës - Fushë Nepravishtë” dhe “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë”. Në vitin 2018 janë realizuar gjithsej 6 investime, për të cilat janë hartuar projektet përkatëse, nga të cilat tre projekte janë dhuruar nga projektuesit privatë, përkatësisht për objektet “Rikonstruksion dhe ndërtim palestere e shkollës “Avni Rustemi”, Libohovë”, “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” dhe “Rikonstruksion i ujësjellësve”. Për shtatë projektet e mësipërm të dhuruar është hartuar akt dhurimi midis njësisë vendore dhe projektuesit, por nuk ishte bërë hyrja e tyre në magazinë (kjo u realizua gjatë periudhës së auditimit në subjekt), si dhe nuk është bërë ende rregjistrimi në kontabilitet i vlerës së projekteve, me pretendimin se janë dhuruar dhe nuk kanë vlerë financiare në aktin e dhurimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Rubrika -Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandim: Njësia vendore të marrë masa për rregjistrimin në kontabilitet të shtatë projekteve të dhuruara nga subjekte private. Për këtë qëllim nga titullari të ngrihet komision për përcaktimin e vlerës së secilit projekt. Në raste të tjera në bashkëpunim dhe mirëkuptim me donatorin, të merret edhe fatura që identifikon mallin dhe vlerën e saj.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

8. Gjetje nga auditimi: Nga sektori i financës për vitin 2017 dhe 2018 nuk është mbajtur ditar i blerjeve, por vetëm ditar dhe libër magazine, duke mos rregjistruar dhe kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe progresive të gjithë veprimtarinë e blerjeve të institucionit, por vetëm atë veprimtari që lidhet me blerjen e mallrave (jo shërbimet dhe punimet). Për shërbimet dhe punimet janë mbajtur rregjistrime të përkohshme (por jo në forme kontabiliteti). Nuk është mbajtur libër i madh për rregjistrimet përmbledhëse mujore të kontabilitetit (tepricat debitorë dhe kreditorë sipas llogarive). Mos kryerja e këtyre veprimeve ka sjellë edhe anomalitë e konstatuara në pasqyrat financiare për të dy vitet.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kapitulli II, rubrika 2.2 - Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik,

pika 6, rubrika 2.3 - Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik, pika 7 dhe 8, kapitulli II, rubrika 3.2, pika 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Nga sektori i financës për vitin 2019 të hapet ditar i blerjeve, në të cilin të regjistrohen dhe kontabilizohen të gjitha blerjet që kryen institucioni, sipas kronologjisë kohore të ndodhjes, të hapet libri i madh ku të regjistrohen tepricat mujore kreditore dhe debitorë të të gjitha llogarive.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

9. Gjetje nga auditimi: Njësia vendore Bashkia Libohovë ka ngritur komisionin e inventarizimit të aktiveve, i cili në përfundim të procesit ka hartuar dhe firmosur fletët e inventarizimit, por nuk ka hartuar për titullarin një raport lidhur me procesin e inventarizimit fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike etj., në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 85/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 42-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të kërkohet që në fund të procesit të inventarizimit, komisioni i ngritur për këtë qëllim, të hartoj një raport në të cilin të informojë titullarin për rezultatet e inventarizimit, mangësitë e konstatuara, kushtet e ruajtjes së aktiveve, gjendjen fizike të tyre, listën e aktiveve që mendon se duhen nxjerrë jashtë përdorimit etj.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, regjistri i riskut, harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit. Grupi i menaxhimit strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet. Njësia ka në strukturë specialist të IT-së, por nuk janë hartuar rregulla dhe nuk janë marrë masa konkrete për mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik, nuk ka sistem rezervë (back-up).

Vlerësimi i funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është bërë si duhet nga menaxherët kryesor, duke mos përcaktuar pikat e dobëta të këtij sistemi, e marrjen e masave për përmirësimin e tyre. Nga stafi nuk njihet mjaftueshëm ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe manuali përkatës në zbatim të këtij ligji. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenin 32, të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, duke siguruar sisteme rezervë të IT (back-up). Të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Deri më 30.11.2019

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë ka lidhur kontratën nr.2, datë 17.04.2018 me qiramarrësin P.K., me objekt “*Dhënie me qira të fundit kullor për një afat 3 vjeçar*”, por prej qiramarrësit janë shkelur në mënyrë të dukshme kushtet e kontratës, pasi janë ndërtuar në sipërfaqen e marrë me qira ndërtime të përhershme pa lejen e organeve kompetente. Nga qiramarrësi është refuzuar njoftimi i bashkisë për kthimin në gjendjen e mëparshme të ambientit, por njësia vendore nuk ka ndërmarrë masa të mëtejshme ligjore për zgjidhjen e çështjes, si zgjidhje të kontratës, njoftim të organeve kompetente për shkeljet e konstatuara etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Njësia vendore të marrë masat e duhura ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshme të ambientit të marrë me qira, duke mos lejuar të kryhen ndërtime të përhershme jashtë kontratës dhe kuadrit rregullator në fuqi. Të ndërmerren masa të mëtejshme duke bërë

zgjidhjen e kontratës, njoftimin e organeve kompetente për ndërhyrjen e tyre e deri në kallëzim penal ndaj qiramarrësit për zgjidhjen e çështjes.

Deri më 30.11.2019

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë nuk ka ndjekur si duhet zbatimin e kontratave të lidhura për objektet e dhëna me qira me subjektet V... SHA, A... SHA, T... SHA, si dhe nuk ka njoftuar në kohë këto subjekte për pagesën e detyrimeve, sipas afateve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

Nuk janë zbatuar kushtet e kontratës në lidhje me afatin e pagesës së qirasë. Gjithashtu në hartimin e kontratës nuk janë parashikuar penalitete për qiramarrësin, por vetëm për qiradhënësin (njësinë vendore), në rastet kur shkelen kushtet e kontratës. Zyra e taksave dhe tarifave vendore nuk ka regjistër të saktë, ku të evidentohet rregjistrimi i kontratës, zbatimi i saj nga subjekte qiramarrëse për likuidimin e detyrimeve kontraktore, për të përcaktuar saktë nëse subjektet i kanë kryer në kohë pagesat.

Mangësitë e mësipërme në formulimin e kontratave të qirasë ka vendosur në kushte jo të barabarta qiradhënësin (njësinë vendore), në raport me qiramarrësin.

Kontratat e qirasë midis Bashkisë Libohovë me subjektet qiramarrëse T... A... SHA dhe A... SHA, nuk janë lidhur me akt noterial, në kundërshtim me nenin 83, paragrafi I i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Bashkia Libohovë nëpërmjet strukturave përgjegjëse në marrëveshje me qiramarrësin, të riformulojë kushtet e kontratës me subjektet V... SHA, A... SHA, T. SHA, në përputhje me nenin 83 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ku të përcaktohen qartë penalitetet, mënyra dhe koha e realizimit të tyre për të dyja palët. Zyra e taksave dhe tarifave vendore dhe sektori i financës të krijojë regjistër me të dhëna mbi kontratat, i cili do të shërbejë për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.

Deri më 30.11.2019

13. Gjetje nga auditimi: a- Bashkia Libohovë ka lidhur kontrata për dhënien me qira të kullotave me 5 subjekte të cilët rezultojnë debitor ndaj bashkisë për kontratat e mëparshme, respektivisht: kontrata e datës 22.05.2017 me subjektin F.C. (ndërruar kontrata në emrin e familjarit tjetër R.C.), kontrata e datës 23.05.2017 me subjektin B.B., kontrata e datës 23.05.2017 me subjektin T.G., kontrata e datës 12.06.2017 me subjektin S.H., dhe kontrata e datës 08.06.2017 A.B., të cilët në total i detyrohen Bashkisë Libohovë vlerën 1,026,800 lekë.

b- Kontratat e dhënies me qira nga fondi kullor për kullotje dhe kositje bari, në shumicën e rasteve nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e duhur si vërtetimi nga njësia administrative për numrin e krerëve, certifikata veterinare, kërkesa për kullotën e kërkuar, etj, veprime në kundërshtim me pikën 4 dhe 5, Kreu II, të udhëzimit nr. 2, datë 20.07.2016 “*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari*”.

c- Nga specialisti i bujqësisë nuk janë kryer kontrole në terren për zbatimin e kontratave për kullotat e dhëna me qira (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandim: a- Titullari i njësisë vendore të marrë masa që në vijimësi, rinovimi apo lidhja e kontratave të reja me të tretët për dhënien me qira të kullotave, të bëhet pasi qiramarrësi të ketë shlyer detyrimet e mëparshme ndaj njësisë vendore dhe të jetë paraqitur prej tyre i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor.

b- Mbështetur në kuadrin rregullator në fuqi të hartohet lista e dokumenteve që duhet të paraqesin aplikuesit për qiramarrje dhe të verifikohet plotësimi i tyre. Të merren masa që nga qiramarrësit e mësipërm krahas shlyerjes së detyrimeve për kontratën e re, të kryhen pagesa edhe për detyrimet e prapambetura nga kontrata e mëparshme. Për këtë të hartohet akt marrëveshje me qiramarrësit.

c- Nga specialisti i bujqësisë të ushtrohen kontrole në terren lidhur me zbatimin e kontratave të kullotave. Për këtë të mbahet akt kontrolli i cili të bëhet pjesë e dosjes së qiramarrësit dhe për çdo mangësi të konstatuar gjatë kontrollit të informohet titullari i njësisë vendore.

Deri më 30.11.2019 dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i paketës fiskale të viteve 2017, 2018, dhe 2019, u konstatua se është parashikuar si e ardhur për buxhetin e bashkisë edhe tarifa e ndriçimit rrugor, miratuar me VKB, në të cilën theksohet se “*Kësaj tarife i detyrohen vetëm qytetarët dhe njësit administrative që mbulohen nga ndriçimi rrugor*”, pa përcaktuar rregulla konkrete se si do të mbliidhet kjo tarifë, cilët janë familjet, bizneset etj., që përfitojnë këtë shërbim dhe që do të jenë subjekte të pagesës së kësaj tarife, duke u bërë shkak në mos realizimin e kësaj të ardhure për buxhetin e bashkisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandim: Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkisë, të merren të gjitha masat për të evidentuar numrin e familjeve, bizneseve etj, që përfitojnë nga ndriçimi rrugor dhe që duhet të paguajnë detyrimet për këtë shërbim të ofruar, dhe t’ia paraqesin Këshillit Bashkiak për miratim, duke krijuar edhe një regjistër elektronik për këtë qëllim. Të përcaktohet mënyra e mbledhjes së kësaj tarife.

Deri në hartimin e paketës së re fiskale

15. Gjetje nga auditimi: Njësia e burimeve njerëzore dhe titullari i institucionit, nuk kanë bërë vlerësimin 6 mujor të rezultateve të punës për 13 punonjësit me statusin e nëpunësit civil, duke mos verifikuar në këtë mënyrë realizimin nga ana e punonjësit të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, nivelin e aftësive, apo dobësitë e tij në kryerjen e detyrës. Mos kryerja e vlerësimit të rezultateve në punë, nuk synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit prej tij. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 62, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 datë 18.12.2014 dhe VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me VKM nr.252, datë 30.03.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandim: Njësia e burimeve njerëzore dhe titullari të bëjë vlerësimin 6 mujor të punonjësve që kanë përfituar me akt statusin e nëpunësit civil, me qëllim verifikimin e performancës në lidhje me detyrën funksionale dhe synimin e përmirësimit të aftësive profesionale. Vlerësimet të bëhen sipas formularëve TIP dhe të vendosen në dosjen individuale.

Në vijimësi

16-Gjetjet nga auditimi: Bashkia Libohovë në hartimin e buxhetit vjetor në zëri shpenzime, nuk ka të programuar për detyrimet e prapambetura, në të cilin ka diferenca të dukshme ndërmjet treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Treguesit e buxhetit për këtë zë me gjitha ndryshimet në total janë realizuar në periudhën raportuese 2017 në masën 60%, ndërsa për periudhën raportuese 2018 në masën 85%. Në këto tregues zëri me nivelin më të ulët të realizimit janë “*Investimet*” respektivisht në masën 54% e 76%. Programimi zërave të shpenzimeve dhe investimeve, si dhe mos realizimi kanë shkak mos realizimi të ardhurave, duke sjell mos plotësim të nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

-Nuk është hartuar PBA për vitin 2016. Në hartimin dhe zbatimin buxhetit vjetor të vitit 2017 nuk ka rakordim me PBA e hartuar për këtë periudhë, pasi buxheti i vitit 2017 nuk ka përputhje me vitin e parë të PBA së hartuar. Njësia publike Bashkia Libohovë më datën 31.12.2018 ka fatura të pa likuiduara në vlerën totale **16,485,845 lekë**, në të cilën janë përfshira edhe detyrimet e pa likuiduara të mbartura nga (*ish/Komunat*) gjendje e pa ndryshuar në vlerën **10,798,473 lekë** dhe pjesa tjetër shuma **5,687,372 lekë** janë detyrime të krijuara gjatë aktivitetit të Bashkisë për periudhën 2017-2018. Veprime në mospërputhje me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe neni 52 “*Kryerja e shpenzimeve*” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, UMF nr.5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014, si dhe UMFE (*plotësues*) nr.02, datë 10.01.2018 “*Për buxhetin e vitit 2018*”, pika

(82) dhe (91) “*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*” (Më hollësisht trajtuar në pikën B1, faqet 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandim:

a-Me qëllim që të mos krijohen diferenca të theksuara ndërmjet programimit dhe realizimit të treguesve të buxhetit, njësia publike Bashkia Libohovë të marr masa për hartimin sa më real të treguesve të buxhetimit, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Njëkohësisht në çdo periudhë buxhetore të hartohet (PBA) dhe buxhetit vjetor të ndjek parashikimin e vitit të parë të PBA.

b-Titullari i njësive vendore dhe Sektori Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, të marr masa të plota për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **16,485,845 lekë**, në zbatim të UMF nr.5, datë 27.12.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014, si dhe UMFE (plotësues) nr.02, datë 10.01.2018 “*Për buxhetin e vitit 2018*”, pika (82-91) “*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*” dhe të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë, informacion për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të mbartura dhe të hartojë grafik për shlyerje të tyre.

c-Strukturat drejtuese të njësive vendore, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe strukturat që mbulojnë programimin e monitorimin e treguesve të buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA dhe në programin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i programimit të treguesve të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike, si dhe përmirësimin, programimin e ekzekutimit të treguesve të buxhetit të periudhës koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, për të ruajtur stabilitetin makroekonomik e fiskal.

d-Nevojitet të evidentohen saktë e drejtë konsumi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që “*shkaktojnë*” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme për efekt buxhetor, duke synuar minimizimin e rishpërndarjes mes zërave buxhetor brenda periudhës raportuese ushtrimore. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të ndërmarr veprime të duhura korrigjuese për përmirësim të situatës dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet e ndryshohet.

Me hartimin (PBA) dhe buxhetin e periudhës 2020 e në vijimësi.

17. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë është audituar nga KLSH në vitin 2016 dhe vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Libohovë nga KLSH. Me shkresën nr.1113/122, datë 31.01.2017 është rikërkuar zbatimi i masave të pa zbatuara. Për përmirësimin e gjendjes janë rikërkuar 7 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 7 masa, janë zbatuar 4 prej tyre dhe është në proces zbatimi është 1 masë organizative, ndërsa 2 masa organizative janë të pa zbatuara.

Për shpërblim dëmi janë rikërkuar për zbatim 19 masa me vlerë 12,152,551 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.06.2019, janë arkëtuar 1,619,316 lekë, ndërsa shuma 10,533,235 lekë nuk është arkëtuar. Prej masave të rekomanduara 1 masë është zbatuar, 16 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 masa janë në proces zbatimi. Nuk ka procese gjyqësore në lidhje me masat e rekomanduara (Më hollësisht trajtuar në pikën E faqe 96-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkia Libohovë të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe në vijim të merren masa të menjëhershme për zbatimin e tyre deri në hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e dëmit. Për këtë nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi Grupi i auditimit shqyrtoi ankesën e bërë nga qytetari S.P., protokolluar në KLSH me nr.453, datë 18.06.2019. Qytetari ankohet me pretendimin se “*Rruga hyrëse e lokalit të tij është bllokuar nga një ndërtim i paligjshëm i qytetarit tjetër z. F. R. i cili këtë rrugë e ka bërë pronën e vet në mënyrë të pa ligjshme*”. Nga praktika e mëparshme e kësaj ankese në vitin 2016 konstatohet se për të njëjtin problem z. S.P. në vitin 2016 i është drejtuar KLSH, me ankesën e protokolluar në KLSH me nr.594, datë 25.05.2016. Ankesa është trajtuar nga grupi i auditimit dhe në përfundim KLSH me shkresën nr.510/13, datë 23.09.2016, me lëndë “Për kompetencë dhe veprim”, i është drejtuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Kombëtar, me përmbajtje “*Vlerësimin e ankesës së qytetarit*”. Me shkresën nr.510/14, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, KLSH i ka kthyer përgjigje z. S.P., duke i bashkangjitur edhe shkresën që KLSH i ka drejtuar Kryeinspektorit.

- Në dokumentet e paraqitura nga z. S.P. konstatohet se për çështjen në fjalë prej tij është hapur proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila me vendimin nr. 21-2013-1186/656, datë 08.07.2013 ka rrëzuar kërkesë padinë e z. S.P., me objekt: “*Marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke detyruar të paditurin të pezullojë punimet që kryen për ngritjen e murit rrethues. Detyrimin e të paditurit të lejojë servitutin e kalimit për përdorim të përshtatshëm të pronës sime*”.

Çështja është ndjekur nga ankimuesi në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, e cila me vendimin nr.174, datë 10.04.2014 ka rrëzuar përsëri kërkesë padinë e bërë për këtë çështje nga paditësi z. S.P., duke dalë në përfundimin se: “*...Shkaku i rrëzimit të kërkesë padisë sipas Gjykatës së Apelit është se ...prona në të cilën kërkohet krijohet servituti kalimit nga paditësi është e zënë me ndërtim (objekt) dhe nuk është truall, kopsht apo tokë bujqësore. Ekspertët e përcaktuar nga gjykata kanë përcaktuar dy variante për krijimin e servitutit, por këto territore janë në pronësi dhe administrim të bashkisë Libohovë dhe jo në pronësi të të paditurit. Këto variante të përcaktuara nga ekspertët u verifikuan edhe nga trupi gjyqësor dhe vlerësohen si variante të përshtatshme, por për realizimin e tyre paditësi duhet ti drejtohet në rrugë administrative Bashkisë Libohovë, e cila nëpërmjet një studimi pjesor ti krijojë paditësit mundësinë për daljen në rrugë publike*”.

Nga grupi i auditimit për mungesë të dokumentacionit të objektit të z. F.R., pasi ky dokumentacion nuk ndodhet në njësinë vendore Libohovë, nuk mund të gjykohej nëse ndërtimi për të cilën qytetari ankohet se i ka bllokuar rrugën, është ndërtim i pa ligjshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën F faqe 98-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Mbështetur në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile i republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 36 ku parashikohet se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata”, si dhe në kushtet kur Gjykata e Apelit ka marrë vendim dhe ankimuesi deklaron se është në vazhdim të ndjekjes së këtij procesi në Gjykatën e Lartë, KLSH nuk mund të shprehet për këtë çështje. Në vijim të qëndrimit brenda zgjidhjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Libohovë që në bashkëpunim me qytetarin të trajtojë problemin e tij për të krijuar servitut kalimi nga prona e tij në rrugën kryesore. Për këtë të shqyrtohen variantet e përcaktuara nga ekspertët e caktuar nga gjykata. Bashkia Libohovë të njoftojë ankimuesin dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit për veprimet e marra.

Deri më 30.11.2019

19. Gjetje nga auditimi: Njësia e auditit të brendshëm nuk ka çelur dosjet e përhershme për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3 Dosjet koherente nuk janë mbajtur e plotësuar në përputhje me standardet e Kapitullit VI të MAB, pasi në to nuk është përfshirë gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme dhe nuk janë dorëzuar në arshivë. Kjo njësi nuk ka ndjekur si duhet zbatimin e rekomandimeve nga subjekti Bashkia Libohovë, si ato të dhëna nga KLSH, edhe rekomandimet e lena nga vetë NJAB. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, standardet e përcaktuara në Kap. VII, pika

4.1.12. Hapi 11 të MAB (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandim: Nga njësia e auditit të brendshëm të çelen dosjet e përhershme të auditimit, duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja, me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse. Pas përfundimit të auditimit, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin dhe informacionet e nevojshme, si dhe të arkivohen ato arkivin e Bashkisë Libohovë, në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njesisë Publike** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,615,166 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt “*Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës “Kthesa e Labovës - Labovë e Kryqit”*”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 148,369,041 lekë me TVSH, shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “G...” SHPK & “A...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Mbushje me material ranor mbas strukturave”; “Shtresë asfalto betoni me zall lavatriçe, me t=3 cm”; “Shtresë binderi me zall lavatriçe, me t=3 cm”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **1,218,620 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 17.10.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “G... SHPK” & “A...” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,218,620 lekë pa TVSH** nga OE “G...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. Prot, datë 17.10.2016, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës “Kthesa e Labovës - Labovë e Kryqit”*”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë*”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 134,989,797.68 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik “A...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Transport dheu me auto deri në 5 km”; “Beton C 25/30 për strukturë për rrugë t = 15 cm”; “Kunetë guri t = 6 cm”; “Shtresë çakëll mbeturinë kave t = 25-30 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”; “Beton C 16/20 për strukturë për rrugë t=10 cm”; “F.V Zgarë hekuri tek Ø 10 çdo 20 cm (trotuari)”; “Pllakë guri raror, gri, 20 cm x dim i lirë t = 6 cm, një faqe e buxharduar”; “F.V Shtresë llaç çimento, 4 cm (fiksion pllake)”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **1,148,247 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 08.08.2017, të lidhur mes Autoritetit

Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomik “A...” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,148,247 lekë pa TVSH** nga OE “A...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. Prot, datë 08.08.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë*”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)*”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës **58,181,817 lekë** me TVSH, shpallur fitues Operatori Ekonomik “M...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Shtresë stabilizanti 15 cm përhapur + ngjeshur mak”; “Shtresë asfalto betoni me zall lavatriçe, me t=3 cm”; “Shtresë binderi me zall lavatriçe, me t=5 cm”; duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **1,071,155 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 03.03.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Operatorit Ekonomikë “M...” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,071,155 lekë pa TVSH** nga OE “M...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. Prot, datë 03.03.2017, për kryerjen e punimeve me objekt “*Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhes (loti I)*”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt “*Rikonstruksion dhe ndërtim palestër në shkollën 9-vjeçare “Avni Rustemi”*”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 65,212,909 lekë me TVSH, shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “E...” SHPK & “E...” SHPK & “R...” SHPK, përfaqësuar nga (OE) “E...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **454,464 lekë pa TVSH**, për zërat e punimeve: “F.V Koromane dërrase 15 cm, klasa + korridore” dhe “Furnizim e mbjellje peme dekorative”. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 11.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Libohovë dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “E...” SHPK & “E...” SHPK & “R...” SHPK, përfaqësuar nga OE “E...” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Libohovë, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “E...” SHPK & “E...” SHPK & “R...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që shuma **454,464 lekë pa TVSH** e përfutuar tepër për punime të pakryera në volumet e përcaktuara në projekt –preventivin e objektit, të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (data 07.01.2020). Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Libohovë, mbikëqyrësi i punimeve si dhe kolaudatori i punimeve të objektit. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Deri më 31.10.2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksion i kanalit ujitës fusha e Suhes (Ushqyes i rezervuarit të Cinit) Loti I*”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 6,526,073 lekë me TVSH, shpallur fitues Operatori Ekonomik “N...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Prerje e pastrim nga ferrat në kanal in ekzistues”; “Hidroizolim me 2 duar bitum”; “Gabiona me rrjetë teli (1x1x1)m”; “Plate kalldrëm mbushje me gurë D=80 cm”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **404,700 lekë**

pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 06.06.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Operatori Ekonomik (OE) “N...” (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **404,700 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik (OE) “N...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. prot, datë 06.06.2016, për kryerjen e punimeve me objekt “Rikonstruksion i kanalit ujitës fusha e Suhes (Ushqyes i rezervuarit të Cinit) Loti I”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Kthesa e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 12,533,789 lekë me TVSH, shpallur fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A...” SHPK & “B...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Gërmim seksion i lirë me ekskavator + transport me skreper ...”; “Mbushje me material rrethanor + ngjeshje”; “F.V Tombino (Tuba b/a Ø 800 mm)” dhe zëri “Beton C 16/20 (Portali i hyrjes dhe daljes së tombinove)”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **184,480 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 16.05.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “A...” SHPK & “B...” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **184,480 lekë pa TVSH** nga Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “A...” SHPK & “B...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. Prot, datë 16.05.2018, për kryerjen e punimeve me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Kthesa e Nepravishtës-Fushë Nepravishtë”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme”, Bashkia Libohovë, me vlerë të kontratës 1,398,792 lekë me TVSH, shpallur fitues Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T...” SHPK, & “C...” SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: “Shtresë betoni C 16/20 sipas profilimit në rrugë”; “Mbushje për profilim me çakëll”; “Mbushje për profilim me çakëll”, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **133,500 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. Prot, datë 04.09.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Libohovë dhe sipërmarrësit Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T...” SHPK, & “C...” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Libohovë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **133,500 lekë pa TVSH** nga Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “T...” SHPK, & “C...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me pa nr. Prot, datë 04.09.2018, për kryerjen e punimeve me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme”, Bashkia Libohovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Deri më 31.10.2019

B.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Në katër raste janë konstatuar shkelje të procedurave të prokurimit publik, të cilat kanë sjellë kualifikim të operatorit fitues i cili nuk plotëson kriteret dhe specifikimet e vendosura në DST, me pasojë përdorim të fondeve publike pa economicitet, eficiency dhe efektivitet në vlerën totale 128,995,868 lekë pa TVSH.

Në tre raste janë s'kualifikuar operatorë ekonomikë për devijime të vogla, duke sjellë efekte financiare negative në buxhet në vlerën totale 14,406,578 lekë pa TVSH. Gjithashtu efekt negativ në buxhet kanë pasur edhe shpenzimet për zbatimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 2,850,441lekë, në mënyrë të detajuar si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt "Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës kthesa e Labovës - Labove e Kryqit", zhvilluar në datën 12.9.2016, me fond limit 124,999,984 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë 4 OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST. Nga KVO është kualifikuar dhe propozuar për shpalljen fitues BOE "G... SHPK & A..." SHPK me vlerë të ofertës 123,640,868 lekë pa TVSH.

KVO duhet të kishte anuluar tenderin, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Vlera e kontratës prej **123,640,868 lekë pa TVSH** e OE fitues padrejtësisht, do të konsiderohet **përdorim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, germa (ç), neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", pika 1, germa a (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 71-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.2. Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt "*Blerje mjeti zjarrfikës*" me fond limit vlera 3,200,000 lekë pa TVSH është shpallur fitues "*S...*" SHPK me vlerë 3,140,000 lekë pa TVSH, procedurë në të cilën ka marr pjesë 3 OE, ndërkohë me fituesin është lidhur kontrata ndërsa mjeti zjarrfikës është marr në dorëzim nga komisioni pa plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në DST shtojca 8 dhe 9, me pasojë **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën e kontratës prej 3,140,000 lekë**. Komisioni marrjes në dorëzim nuk ka të evidentuara në procesverbal në se janë plotësuar specifikimet që i përkasin; **vitit të prodhimit i cili është 1991; *Kilometrave të përshkruara nga mjeti zjarrfikës të cilat duhet të jenë jo më shumë se 30,000 km; *gjendja e gomave përshkruhet shumë të mira, ndërkohë kërkohen 60 dhe 100% të reja; etj*, njëkohësisht në procesverbal komisioni nuk ka pasqyruar mos plotësimin e specifikimeve teknike që i përket; "*depozita e ujit është kërkuar me 2500 litra, ndërsa mjeti është paraqitur me depozitë uji për 2350 litra; *pesha bosh e mjetit është kërkuar 8000-8100 kg, ndërsa mjeti është paraqitur me peshë 7780 kg; etj*" të cilat duhej të ishin dorëzuar me ofertën ekonomike në procesin e vlerësimit si elemente kualifikimi. Për pasojë kontrata me subjektin është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike të përcaktuara në DST, veprim në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 83-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.3. Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt "*Blerje kontejnera*" me fond limit vlera 1,000,000 lekë pa TVSH është shpallur fitues "*S...*" SHPK me vlerën 775,000 lekë pa TVSH, ose më pak se fondi limit për shumën 225,000 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE, ndërsa janë s'kualifikuar 3 OE me ofertë ekonomike më të lartë se oferta fituese për mungesë në dokumentacionin kualifikues. Me fituesin është lidhur kontratë, ndërkohë që kontejnerët janë marr në dorëzim nga komisioni duke mos plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të pasqyruara në shtojca 9 "*Specifikime teknike*" në DST, me pasojë **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën e kontratës prej 775,000 lekë pa TVSH**. Për pasojë kontrata me subjektin është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike të përcaktuara në DST, veprim në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 75-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.4. Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt "*Blerje kamioni*" me fond limit 1,454,166 lekë pa TVSH është shpallur fitues "*P...*" SHPK me vlerë 1,440,000 lekë pa TVSH, procedurë në të cilën është OE i vetëm pjesëmarrës. Me fituesin është lidhur kontratë, ndërsa mjeti është marr në dorëzim nga komisioni pa plotësuar kriteret e kërkesave kualifikuese të

pasqyruara në DST shtojca 7 “pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.3.7 “Ofertuesi fitues do të shoqëroj çdo automjet me këto dokumente origjinale sipas legjislacionit në fuqi”. OE ka paraqitur vetëm foton dhe lejen e qarkullimi të mjetit, të cilat duhej të ishin dorëzuar me ofertën ekonomike në procesin e vlerësimit si elemente kualifikimi, për pasojë kontrata me subjektin është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike, me pasojë **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën e kontratës prej 1,440,000 lekë pa TVSH**, veprim në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 76-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin nga KVO të OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, si dhe për marrjen në dorëzim të mallit i cili nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DST, nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, me pasojë përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën totale 128,995,868 lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, është edhe risk real për njësinë vendore, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me cilësi të kontratës.

Menjëherë

2.1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rruga Kthesa e Libohovës - Ura e Suhes (loti 1)” me fond limit vlere 58,563,083 lekë pa TVSH është shpallur fitues OE “M...” SHPK me vlerë oferte prej 48,484,848 lekë pa TVSH, ose më pak se fondi limit për shumën 10,078,235 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 13 OE, ndërsa janë s’kualifikuar për mungesë dokumentacioni 12 OE, ndër të s’kualifikuarit edhe oferta ekonomike e BOE “C...” SHPK për vlerën 37,040,250 lekë, me diferencë prej 11,444,598 lekë nga oferta fituese. Nga auditimi rezulton se mangësitë e kësaj oferte janë devijime të vogla dhe moskualifikimi ka shkaktuar **efekt financiar negativ në përdorimin e fondit publike në vlerën 11,444,598 lekë** (diferenca ndërmjet ofertës fituese dhe ofertës së s’kualifikuar), veprime në mospërputhje me nenet 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 59-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitim i kanaleve të rezervuarit të Çinit loti I” me fond limit vlere 13,071,300 lekë pa TVSH është shpallur fitues OE “E...” SHPK me vlerë oferte prej 12,625,988 lekë pa TVSH, ose më pak se fondi limit për shumën 391,312 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE, ndërsa janë s’kualifikuar për mungesë dokumentacioni 3 OE. Ndër të s’kualifikuarit dhe oferta ekonomike e BOE “N...” SHPK me vlerë 9,808,008 lekë, me diferencë prej 2,817,980 lekë nga oferta fituese. Nga auditimi rezulton se mangësitë e kësaj oferte janë devijime të vogla dhe moskualifikimi ka shkaktuar **efekt financiar negativ në përdorimin e fondit publike në vlerën 2,817,980 lekë** (diferenca ndërmjet ofertës fituese dhe ofertës së skualifikuar), veprime në mospërputhje me nenet 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 82-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje mjet zjarrfikëse” me fond limit vlere 3,200,000 lekë pa TVSH është shpallur fitues OE “S...” SHPK me vlerë oferte prej 3,140,000 lekë pa TVSH, ose më pak se fondi limit për shumën 60,000 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 3 OE. Janë s’kualifikuar për mungesë dokumentacioni 2 OE, ndër të s’kualifikuarit dhe oferta e OE “S...” SHPK me vlerë 2,996,008 lekë, e cila plotëson kriteret e DST. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar **efekt financiar negativ në përdorimin e fondit publike në vlerën 144,000 lekë** (diferenca ndërmjet ofertës fituese dhe ofertës së s’kualifikuar), veprime në mospërputhje me nenet 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën D faqe 83-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë vendore të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e mësipërme, me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve të OE me devijime të vogla, e cila ka sjellë si pasojë **efekte negative financiare në vlerën totale 14,406,578 lekë pa TVSH** (tre raste). KVO duhet udhëhiqet nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, sigurimit të efikasitetit maksimale të fondeve dhe dhënies përparësi të ofertës me vlerën më të ulët që plotëson kriteret e vendosura në DST.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Libohovë për periudhën objekt auditimi ka administruar për zbatim 8 vendime gjyqësore në vlerën totale 28,010,891 lekë, nga të cilat 3 vendime në vlerën 869,560 lekë kanë si objekt “Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna”, likuiduar e gjithë vlera brenda vitit 2017, ndërsa 5 vendime në vlerën 27,141,331 janë të natyrave të ndryshme me subjekte private, likuiduar prej saj vlera 1,980,881 lekë. Pra efekti real si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2017 – qershor 2019 është **2,850,441 lekë, efekt negativ financiar për buxhetin e njësisë vendore.**

Pritet ende për likuidim vlera prej 25,160,450 lekë për 2 vendime gjyqësore me objekt: “Dëmshpërblim për dëm të shkaktuar në kullotë”, me vlerë 10,465,650 lekë dhe “Dëmshpërblimin si pasojë e aksidentit në punë me pasojë vdekje”, në vlerën 14,694,800 lekë. Zbatimi i dy vendimeve të mësipërme do të rëndoj shpenzimet e viteve në vazhdim, pasi njësia vendore për shkak të buxhetit të vogël nuk ka mundësi likuidimi brenda një periudhe ushtrimore. Për këtë arsye janë hartuar akt-marrëveshje për pagesën me këste. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me pikën 62 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (Më hollësisht trajtuar në pikën B1 faqe 22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore, ndërsa sektori juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulen rrisqet e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

B.2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRIKUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Libohovë, në fund të vitit 2018 janë krijuar debitorë për taksa dhe tarifa vendore në vlerën totale **21,257,743 lekë**. Ky detyrim përbëhet nga vlera prej **5,544,030 lekë** për **72** subjekte private, vlera prej **12,659,452 lekë** për taksapaguesit e kategorisë familjare dhe vlera prej **3,054,261 lekë** kamatëvonesë për mos pagimin e detyrimeve në kohë. Detyrimi i mësipërm për taksapaguesit familjar përbëhet nga vlera prej **7,178,875 lekë** për 861 familje për taksën e tokës bujqësore, vlera prej **2,125,327 lekë** për 893 familje për taksën e ndërtesës, vlera prej **286,816 lekë** për 763 familje për taksën e truallit, vlera **1,273,100 lekë** për 752 familje për tarifë pastrimi, vlera prej **1,142,580 lekë** për tarifën e ndriçimit, vlera prej **652,754 lekë** për 800 familje për tarifa të tjera vendore.

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e debitorëve veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Zyra e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Libohovë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore: Për 72 subjekte të biznesit të madh e të vogël, debitorë **në shumën 21,257,743 lekë** dhe për 893 familje debitorë për taksa dhe tarifa vendore.

Për subjektet private të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

f- Për të ardhmen, për kategorinë e taksapaguesve familjar, Bashkia Libohovë të përgatisë dhe paraqesë për miratimin në Këshillin Bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “U... Libohovë” SHA, duke i dhënë të drejtë kësaj shoqërie të kryej rolën e agjentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit të pijshëm edhe detyrimin për taksat dhe tarifave vendore familjare.

Deri më 30.11.2019

2. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të njësisë vendore në bashkinë Libohovë ushtron aktivitet tregtim karburanti një subjekt: “L...” SHPK me nr. NIPT J..., i cili nuk ka rinovuar Licencën “për tregtimin me pakicë të karburanteve”, kompetencë e Bashkisë Libohovë, në kundërshtim me kapitullin II, pika 1; e shkronjës “b”, si dhe të pikës 9, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj“, i ndryshuar, me pasojë të ardhura të munguara në vlerën **1,000,000 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Zyra e taksave dhe tarifave vendore dhe titullari i njësisë vendore, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për pajisjen me licencën përkatëse të subjektit “L...” SHPK dhe kryerjen prej tij të pagesës në vlerën 1,000,000 lekë. Në rast të kundërt, të merren masa për të pezulluar ushtrimin e aktivitetit të tregtimit me pakicë të karburantit deri në pajisjen prej tij me licencën përkatëse.

Deri më 31.10.2019

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

Referuar parregullive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara**

në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **12 punonjësve**, për procedurat e prokurimit si më poshtë:

a- Për 4 anëtarët e njësisë së prokurimit, hartues të DST, si më poshtë vijon:

1. Z. I.K., me detyrë zëvendës kryetar i Bashkisë Libohovë (për mangësi në 4 procedura prokurimi);
2. Z. K.K., me detyrë specialist i sektorit të shërbimit urban (për mangësi në 4 procedura prokurimi);
3. Znj. A.L., me detyrë ish përgjegjëse e sektorit juridik (për mangësi në 4 procedura prokurimi);
4. Z. E.T., me detyrë specialistë bujqësie, (për mangësi në 1 procedura prokurimi),
për shkeljet në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve standarde të tenderit (DST) në si më poshtë:

Për mos zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26- Kontratat për punë publike pika nr.5, nr.6, neni 61, pika nr.1 dhe nr.2, në procedurat e prokurimit si më poshtë:

1.Në tenderin me objekt "Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës Kthesa e Labovës - Labove e Kryqit", zhvilluar në datën 12.9.2016, me fond limit 124,999,984 lekë (Trajtuar në faqet 51 deri 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.Në tenderin me objekt "Rikonstruksion dhe ndërtim palestre ne Shkollën 9-vjecare Avni Rustemi", me fond limit 54,405,356 lekë, zhvilluar në datën 16.08.2018 (Trajtuar në faqet 62 deri 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Për tenderin me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës- Fusha Suhe (Ushqyes i Rezervuarit te Cinit", me fond limit 8,218,347 lekë, zhvilluar më 13.04.2016 (Trajtuar faqet 64 deri 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të godinës së Bashkisë Libohovë", me fond limit 2,350,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2016 (Trajtuar në faqet 66 deri 67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b- Për 8 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

1. Z. F.M., me detyrë shëf sektori i shërbimit urban për mangësi të konstatuara në 3 procedura prokurimi;
2. Z. K.J., me detyrë ish n/kryetar i Bashkisë Libohovë për mangësi të konstatuara në 1 procedurë prokurimi;
3. Z. F.Z., me detyrë specialist i bujqësisë për mangësi të konstatuara në 5 procedura prokurimi;
4. Zj. E.Ç., me detyrë përgjegjëse e sektorit ekonomik për mangësi të konstatuara në 4 procedura prokurimi;
5. Z. E.R., me detyrë specialist ne sektorin ekonomik për mangësi të konstatuara në 2 procedura prokurimi;
6. Z. N.R. me detyrë specialist i sektorit të shërbimit urban për mangësi të konstatuara në 3 procedura prokurimi;
7. Znj. B.P., me detyrë specialiste finance për mangësi të konstatuara në 1 procedurë prokurimi
8. Znj. E.L., me detyrë specialiste e njësisë për koordinimin e integritimit European dhe ndihmës së huaj, për mangësi të konstatuara në 1 procedurë prokurimi.

Kuadri rregullator i shkelur nga tetë punonjësit e mësipërm gjatë vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomik si më poshtë vijon:

Për mos zbatim të: a- ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa a, neni 73 “Mungesa e konkurrencës”; b- VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni nr.74- Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3; neni 66, pika 3, me pasojë kualifikimin dhe skualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik.

Shkeljet e mësipërme janë konstatuar në 8 procedurat e prokurimit publik si më poshtë:

1. Për tenderin me objekt "Rehabilitim si dhe rikonstruksion i rrugës Kthesa e Labovës - Labovë e Kryqit", zhvilluar në datën 12.9.2016, me fond limit 124,999,984 lekë pa TVSH (Trajtuar në faqet 67 deri 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2. Për tenderin me objekt: "Blerje kontiniere", me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.04.2017 (Trajtuar faqet 72 deri 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3. Për tenderin me objekt "Blerje automjet kamion", me fond limit 1,454,166 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.06.2017 (Trajtuar faqen 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4. Për tenderin me objekt "Prerje, transport dru zjarri", me fond limit 1,707,400 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 25.10.2017 (Trajtuar në faqen 74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5. Për tenderin me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës- Fusha Suhe (Ushqyes i Rezervuarit të Çinit)", me fond limit 8,218,347 lekë, zhvilluar më 13.04.2016 (Trajtuar faqet 75 deri 76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6. Për tenderin me objekt "Rikonstruksion rruga Kthesa Labovës-Ura e Suhës (loti I), me fond limit 58,563,083 lekë pa TVSH, zhvilluar në 29.05.2017 (Trajtuar në faqet 78 deri 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7. Për tenderin me objekt: "Rehabilitim i kanaleve të rezervuarit të Çinit loti I", me fond limit 13,071,300 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.06.2017 (Trajtuar në faqet 79 deri 80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8. Për tenderin me objekt: "Blerje mjeti zjarrfikës", me fond limit 3,200,000 lekë, zhvilluar në datën 11.03.2019 (Trajtuar faqet 80 deri 81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Qendror (IMTQ)

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 3 Kreu II, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Libohovë t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror (Për arsye të mungesës së Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) pranë Bashkisë Libohovë) që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative "Dënimin me gjobë", për mbikëqyrësit, si më poshtë:**

1. **Z. T.S.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rehabilitimi si dhe rikonstruksioni i rrugës "Kthesa e Labovës - Labovë e Kryqit", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh BOE "G..." SHPK & "A..." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, Datë 17.10.2016 me vlerë 148,369,041 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,218,620 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.
2. **Z. A.K.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh OE "A..." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, datë 08.08.2017 me vlerë 134,989,797.68 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,148,247 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.
3. **Z. E.B.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: "Rikonstruksion i rrugës kthesa – ura e Suhës (loti I)", Bashkia Libohovë, me sipërmarrës punimesh OE "M..." SHPK, sipas kontratës pa Nr. Prot, Datë 03.03.2017 me vlerë 58,181,817 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,071,155 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Në shkresën që Kryetari i Bashkisë Libohovë do t'i dërgojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Qendror, të bashkëngjiten kopje të akt konstatimit nr.7, datë 09.08.2019, akt konstatimit nr.8, datë 09.08.2019, akt konstatimit nr.9, datë 09.08.2019 "Për zbatimin e

kontratave të punimeve”, si dhe pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga faqja 86 deri në faqen 96, ku trajtohet pika e zbatimit të kontratave të punimeve.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Libohovë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “*Mbajta deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj*” deri më “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*“, **për 3 punonjësit e mëposhtëm:**

1. Zj. E.Ç., me detyrë përgjegjëse e sektorit ekonomik, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi në paraqitjen e të dhënave në pasqyrat financiare, mos hartimin e rregjistrit të aktiveve, mos çeljen e ditarit të kontabilitetit, librit të madh etj., konkretisht: mos zbatimin e kërkesave të UMF 14 dt. 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive qe varen prej tyre si dhe te njërive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj”; Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

2. Z. X.S., me detyrë përgjegjëse i sektorit të taksave dhe tarifave vendore, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr. 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB për paketën fiskale, duke mos realizuar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore për 72 subjekte të biznesit të madh e të vogël, dhe për 893 familje debitorë për taksa dhe tarifa vendore në shumën 21,257,743 lekë.

-Për mos zbatimin e kërkesave të kapitullit të II, pika 1; e shkronjës “b”, si dhe të pikës 9, të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar. Nga mos rinovimi i licencës dhe mos kryerja e pagesës për të, nga subjekti “L...” SHPK, buxhetit të Bashkisë Libohovë i janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 1,000,000 lekë.

3. Z. F.Z., me detyrë specialist i zyrës së bujqësisë, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të kërkesave të pikës 14, dhe 15, Kreu II, të Udhëzimit nr.2, datë 20.07.2016 “*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari*”, janë lidhur kontrata për dhënien me qira të kullotave me 5 subjekte të cilët rezultojnë debitor ndaj bashkisë për kontratat e mëparshme, si kontrata e datës 22.05.2017 me subjektin F.C. (R.C.), kontrata e datës 23.05.2017 me subjektin B.B., kontrata e datës 23.05.2017 me subjektin T.G., kontrata e datës 12.06.2017 me subjektin S.H., dhe kontrata e datës 08.06.2017 A.B., të cilët në total i detyrohen Bashkisë Libohovë vlerën 1,026,800 lekë.

-Për mos zbatim të kërkesave të pikës 4 dhe 5, shkronja “a, b, c”, Kreu II, të Udhëzimit nr.2, datë 20.07.2016 “*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari*”, kontratat e dhënies më qira nga fondi kullor për kullotje dhe kositje bari, për vitin 2017, në shumicën e rasteve nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e duhur si vërtetimi nga Njësia Administrative për numrin e krerëve, certifikata veterinare, kërkesa për kullotën e kërkuar, etj.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 9 të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Libohovë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “*Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës*”, për 1 punonjës si më poshtë:

1. Z. A.I., me detyrë specialist në sektorin e taksave dhe tarifave vendore, *për shkeljet e mëposhtme:*

-Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr. 9920, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB për paketën fiskale, duke mos realizuar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore për 72 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 893 familje debitorë për taksa dhe tarifa vendore në shumën 21,257,743 lekë.

D.3. Për punonjësit të cilët janë në periudhë prove për statusin e nëpunësit civil si më poshtë vijon, të cilët janë identifikuar për mangësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për shkak përvojës së pakët në kryerjen e detyrës funksionale, nuk rekomandojmë masa disiplinore, por shkeljet e tyre të kihen parasysh në vlerësimin përfundimtar të periudhës së provës:

1. Z. J.R., me detyrë jurist i zyrës juridike

2. Z.R.T., me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore.

D.4. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Libohovë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë të mos propozohet masë, si më poshtë:

1. Znj. J.M., me detyrë specialiste e financës.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore sa më sipër, Bashkia Libohovë, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

